Kronikë

Mirditë/ Iu gjetën rreth 25 kg kanabis, kallashnikov dhe 2 radio policie gjatë kontrolleve në banesë e magazinë, arrestohen 2 vëllezërit

Policia ka arrestuar 2 vëllezër në Mirditë pasi gjatë kontrolleve në banesë e magazinë iu gjetën drogë, armë dhe radiomarrëse si të policisë.

HOROSKOPI

Redaksia
25 Janar, 14:03 | **Përditesimi: 25 Janar, 14:17**

Share

MIRDITË-Policia ka arrestuar 2 vëllezër, pasi gjatë kontrolleve në banesë e magazinë iu gjetën kanabis, armë dhe radiomarrëse si të policisë.

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Mirditë finalizuan operacionin policor të koduar "Double Strike", ku në pranga kanë rënë vëllezërit Ilir Deda, 40-vjeç dhe Pashk Deda, 45-vjeç, banues në fshatin Kullaxhi.

Sipas policisë, nga kontrolli në magazinë u gjetën dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale tre thasë me kanabis në formë boçeje, gjithsej 24.5 kilogramë, ndërsa nga kontrolli në banesë u gjetën dy armë zjarri (kallashnikov e pushkë), 4 armë gjahu, 2 radio marrëse-dhënëse si të Policisë, 1 shkop gome, 1 shkop bejzbolli, 1297 fishekë luftarak dhe 17 fishekë çifteje.

LEXO EDHE:
Dy makina përplasen në aksin Lezhë-Shkodër, plagosen tre persona

> *'Armët e zjarrit do dërgohen për ekspertim në Institutin e Policisë Shkencore për të parë nëse janë përdorur më parë për kryerje të veprave penale kundër personit', njoftoi sot policia.*

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për veprime të mëtejshme për veprat penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit" , "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive", "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", "Fshehja e të ardhurave", "Mbajtja pa të drejtë e uniformës", kryer në bashkëpunim.

S.B/Shqiptarja.com

TAG: Ilir Deda | Pashk Deda | kanabis | Lezhe | mirdite | municion luftarak

Komento

Komente

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: 25 Janar, 13:37
A duhet të votojnë emigrantët që kanë vetëm dokumente identifikimi të huaja?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

'Riaktivizohet' marrëveshja me Italinë, anija 'Cassiopea' pritet të sjellë emigrantët më 27 janar në Shëngjin
25 Janar, 08:48

Riaktivizohet marrëveshja Itali-Shqipëri! Anija 'Cassiopea' gati për të sjellë emigrantë në Shëngjin
24 Janar, 15:56

Dekreti i Presidentit, Trump shqetëson afganët në Shëngjin: Pa Amerikën e ardhmja jonë është në rrezik
Elvis Hila
24 Janar, 15:43

Tiranë/ Shisnin kanabis dhe kokainë, arrestohen dy të rinjtë! Policia sekuestron edhe 10 mijë euro (EMRAT)
24 Janar, 14:53

Gjirokastër/ Goditën me sende të forta një person, arrestohet 31 vjeçari, në kërkim i vëllai
24 Janar, 13:21

Arrestohet në Fushë-Arrëz 29-vjeçari i akuzuar për shitje narkotikësh, kërkohej prej korrikut pasi theu arrestin shtëpiak (EMRI)
23 Janar, 20:35

Fushë-Arrëz/ 62-vjeçari gjendet i pajetë në lumin Fan, dyshohet se u rrëzua aksidentalisht (EMRI)
23 Janar, 20:20

Rruga me gropa në Raboshtë të Lezhës, banorët: I lamë lekët në servis për amortizatorët e makinave
Elvis Hila
23 Janar, 14:15

VKM/ Qeveria miraton kriteret për parcelat e kultivimit dhe rritjes së kanabisit mjekësor
22 Janar, 18:41

Me shpejtësi të lartë dhe parakalime të gabuara, Rrugorja e Lezhës: 2053 gjoba gjatë janarit, 8 shoferë në pranga
22 Janar, 11:25

Lezhë/ Vodhën para në një berberhane duke thyer xhamat, kapen dy të miturit! 17-vjeçarit i gjendet edhe një dorezë metalike
22 Janar, 10:33

Aksident në aksin Lezhë- Shkodër, përplasen 2 automjete, plagoset njëra prej shofereve
22 Janar, 10:09

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje